



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Nr. Prot. 62

Tiranë, 24/04/2020

VENDIM

Nr. 01 datë 24/04/2020

PËR

**NJË NDRYSHIM TË RREGULLORES SË PAGAVE NR. 299, DATË
21.11.2016, MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES NR. 62,
DATË 21.11.2016**

Në zbatim të Nenit 6, gërma “b” e Ligjit Nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Nenit 6.1, gërmat “a” dhe “b” e VKM Nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Rregullores së Pagave nr. 299, datë 21.11.2016, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 62, datë 21.11.2016, Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 106, datë 09.03.2020 “Për ndalimin e të gjitha lëvizjeve me mjetet e transportit ajror në veriun e Italisë”, i ndryshuar me Urdhrin nr.108, datë 09.03.2020 dhe Urdhrin nr.116, datë 10.03.2020, me qëllim përballimin e situatës së vështirë ekonomike të Autoritetit të Aviacionit të Aviacionit Civil, si pasojë e pandemisë COVID-19, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, Këshilli Drejtues,

VENDOSI

1. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 62, datë 21.11.2016, ndryshon si më poshtë vijon: “Paga bazë në vlerë absolute e Drejtorit Ekzekutiv të jetë në shumën 168,000 lekë”.
2. Paga bazë për të gjitha kategoritë e tjera ndryshon sipas përcaktimeve të Lidhjes II të Rregullores.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më datë 1 Prill 2020 dhe do të vazhdojnë deri në një vendim tjetër.
4. Efektet financiare të reflektohen në Programin Ekonomik të vitit 2020.

5. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Ministri.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Dritan Gjonbalaj